



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

*19 prill 2017, Prizren*

**KOMUNIKATË PËR MEDIA  
Gjakova dhe Prishtina prijnë në transparencë**

EC Ma Ndryshe ka publikuar Indeksën e Reformës së Transparencës Komunale, në kuadër të cilit janë pasqyruar rezultatet për 13 grupe indikatorësh relevantë që tregojnë nivelin e transparencës gjatë vitit 2016 në komunat e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajit, Pejës, Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, si dhe Rahovecit, Vushtrrisë, Malishevës, Suharekës, Klinës, Dragashit, Shtërpcës dhe Mamushës.

Indeksi është lansuar gjatë konferencës, ku panelistët Mimoza Kusari-Lila, kryetare e Komunës së Gjakovës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës së Prishtinës dhe Xhemali Haxhimustafa, nënkryetar i Komunës së Rahovecit kanë prezantuar pikëpamjet e tyre rreth transparencës në komunat respektive, por edhe kanë marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit, që kanë qenë përfaqësues të pushtetit lokal nga komuna të ndryshme, aktivistë të shoqërisë civile, gazetarë, etj.

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila ka pohuar se kryetarëve të komunave në vitin e tyre të katërt të qeverisjes u mbetet të reflektojnë mbi transparencën dhe llogaridhënien dhe hapat që kanë bërë në këtë drejtim. Ajo ka porositur që qëndrueshmëria e praktikave të aplikuara për transparencë të vijojë edhe pas zgjedhjeve lokale ashtu që të mbahet komunikimi i hapur me qytetarët dhe OJQ-të.

Ndërsa Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës së Prishtinës ka theksuar se qytetarët mund të jenë hisedarë në qeverisjen komunale vetëm nëse informohen drejtë dhe saktë për politikën dhe vendimmarrjen në pushtetin lokal.

Xhemali Haxhimustafa, nënkryetar i Komunës së Rahovecit ka shprehur qëndrimin se gatishmëria e të parit të komunës për llogaridhënie luan rol të rëndësishëm në reformimin e transparencës së Komunës.

Në Indeksën e Reformës së Transparencës Komunale për vitin 2016 figuron se Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës përbëjnë grupin e parë të komunave transparente me 66 për qind të vlerësimit të përgjithshëm, pastaj radhiten Peja e Gjilani me 51 përkatësisht 50 për qind, të pasuara nga Mitrovica me 47 për qind, Ferizaj 43 për qind e Prizreni 39 për qind. Te komunat që nuk janë qendra rajonale prijnë Rahoveci dhe Vushtrria me 48 për qind, pastaj Malisheva me 43 për qind, Suhareka 42 për qind, Klina 41 për qind, Shtërpca 37 për qind, Dragashi 31 për qind dhe Mamusha me 26 për qind.

Transparenca në luftimin e keqpërdorimeve, prokurimin publik, menaxhimin e pronës komunale, pastaj në planifikimin urban dhe monitorimin e projekteve urbanistike mbeten sfida të rëndësishme për komunat.

Grupet e indikatorëve që janë monitoruar dhe mbi të cilat është shkruar Indeksi janë: Kryetari, Drejtorët dhe Anëtarët e Kuvendit, Organizimi dhe funksionimi, Puna e organeve politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, Luftimi i sjelljeve të pahijshme dhe keqpërdorimeve, Integrimi Evropian, Kontabiliteti dhe buxheti, Kontratat e prokurimit publik, furnizimit dhe granteve, Të punësuarit në administratën publike dhe organizatat/institucionet publike, Pasuria kapitale dhe jokatitale, Informimi dhe shërbimi i qytetarëve, Bashkëpunimi me shoqërinë civile, Planifikimi urban dhe Monitorimi i projekteve urbanistike. Përmbajtjen e plotë të Indeksit mund ta lexoni në linkun: <http://online-transparency.org/indeksi/>

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale”, EC Ma Ndryshe e ka iniciuar nga maji i vitit 2015 dhe i njëjti ka shtrirje në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, pastaj Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë, Shtërpçë, Vushtrri dhe Klinë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre.

Me respekt,

OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771